



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
14.1.2015, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Qendron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Laura Zherka (PDK), Remzi Pacolli (AKR), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinofci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Besa Rafuna (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Mungoi: Bekim Gashi (LDK).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues. Ai theksoi se këtë mbledhje e kemi thirrur në bazë të kërkesës së GP të LDK-së, nënshkruar nga 17 anëtarë të Kuvendit. Bazuar në nenin 44 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale, takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës, caktohet sipas kërkesës me shkrim nga së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Caktimi i mbledhjes është i bazuar në këtë nen dhe në nenin 3 të Rregullores mbi punën e Kuvendit dhe të komiteteve.

Meqë është mbledhje e jashtëzakonshme, për këtë mbledhje GP i LDK-së e ka propozuar këtë

R E N D D I T E:

1. Shqyrtimi dhe vlerësimi i punës së anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike, të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, theksoi se Grupi Parlamentar i LDK-së, pas shqyrtimit të gjendjes dhe kërkesave që i ka bërë në këtë Asamble rreth informimit nga ana e komisioneve të aksionarëve dhe nga Kryetari për zhvillimet në ndërmarrjet publike, dhe atë në dy mbledhjet e fundit radhazi, për çka nuk na është dhënë përgjigje as nga komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike, e as nga Kryetari i Komunës, dhe duke e parë situatën më shqetësuese në ndërmarrjet publike dhe shkeljet e njëpasnjëshme të ligjit nga ana e komisioneve të aksionarëve, dhe rrjedhimisht më vonë edhe me zgjedhjet e bordeve të cilat u raportojnë këtyre komisioneve, ndërsa këto komisione i raportojnë Kuvendit, kemi thirrur mbledhje të jashtëzakonshme, që ta shqyrtojmë dhe të vlerësojmë, për aq sa mundemi, punën e këtyre komisioneve. Për shkak të zhvillimeve që kanë ndodhur në ndërmarrjet publike lokale, është mirë që ato raporte, me kërkesë të këtij Kuvendi, të vijnë në mbledhjen e parë të radhës dhe t'i analizojmë një nga një.

Ylli Hoxha, shef i GP të LVV-së, për këtë pikë nuk bëri koment.

Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, tha se për të gjykuar se vërtet a ka pasur, apo nuk ka pasur shkelje në këtë ndërmarrje, është dashtë që të kemi informata nga të dy palët. Është më se e nevojshme që ne të kemi një raport drejtpërdrejtë nga komisioni i aksionarëve. Për të marrë vlerësime, për të ditur se si është situata, ne presim, mirëpresim kërkesën për të pasur në seancën e radhës raport nga të gjitha komisionet e aksionarëve, për ta ditur se si është situata në terren. Përndryshe, me kaq sa kemi informata, është e pamundur që ne të marrim ndonjë qëndrim, apo ndonjë vlerësim.

Si GP, e përkrahim plotësisht idenë që të na sillen raportet nga ndërmarrjet publike lokale.

Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, tha se ne jemi të kënaqur me funksionimin e të gjithave atyre ndërmarrjeve. Nuk e di arsyen e seancës së jashtëzakonshme, bëhet fjalë për diçka më personale, apo me të vërtetë është një shqetësim i arsyeshem. Por, pasi që ne nuk kemi aq shumë informata, ne nuk do të implikohemi në këtë.

Jemi për ndryshime, për arsye se nuk bëhet përmirësimi i ndërmarrjeve pa bërë ndryshime.

Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, tha se nuk kemi ndonjë raport që mund të prononcohemi, prandaj për këtë na duhet kohë. Jam çuditur kur e kam parë këtë ftesë për mbledhje të jashtëzakonshme, sidoqoftë, jemi të interesuar të jemi në rrjedha të ngjarjeve që ndodhin.

Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, shprehu mendimin se sa i përket analizës së komisioneve të aksionarëve dhe të bordeve, gjithsesi që duhet të paraqesin raporte. Ato raporte nuk duhet

të vonohen më tepër sesa janë vonuar deri tash. Aty ku jam unë aksionar, kemi pasur probleme me keqkuptimin e ndryshimeve, sepse ndryshimet nuk bëhen shumë lehtë, ndryshimet kanë dhimbje. Në atë ndërmarrje ka pas shumë dhimbje, për shkak se me ndryshime ndërpritej burimi i disa keqpërdorimeve. Keqpërdoruesit prej aty arritën të hynë në disa qarqe kësisoj edhe publike, por edhe interne, që na kanë bllokuar. Pasi t'i shohim arsyetimet e atyre ndryshimeve, arsyetimet pse janë shkarkuar, nëse diku janë shkarkuar me arsye apo pa arsye, atëherë do të mund të marrim ndonjë qëndrim më konkret dhe do të përpiqemi të jemi konstruktiv në ato qëndrimet tona.

Ibrahim Mehmetaj, shef i GP të LB-së, theksoi se ftesa për këtë mbledhje ka qenë e pakuptimtë, me faktin që ka ardhur prej një GP i cili ka themeluar, ka formuar dhe ka udhëhequr me ndërmarrjet komunale, që janë këtu, dhe gjendjet që janë krijuar në ato ndërmarrje, janë prej bordeve familjare dhe bordeve politike që këta i kanë ndërtuar aty. Sa i përket raporteve, janë afatet ligjore kur aksionarët raportojnë në këto seanca. Kryetarit dhe njerëzve të tij që e udhëheqin Komunën, u takon edhe një lëvdatë, sepse kanë arritur ta ndërgjegjësojnë një pjesë të grupeve parlamentare.

Visar Arifaj, në emër të subjektit politik të PF-së, shprehu mendimin se për ta vlerësuar punën e anëtarëve të komisioneve komunale të aksionarëve, do të duhej t'i kishim edhe disa objektiva në bazë të të cilave do të mund të vlerësonim. Në fakt, ato fillimisht neve po na mungojnë për ta vlerësuar punën, që ka qenë shumë e shkurtër prej kohës kur janë zgjedhur deri më sot. Më shumë kemi të diskutojmë për hapat dhe objektivat që duam t'i arrijmë.

Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik të GSI-së, u shpreh i pajtimit me diskutimin e parafolësit, dhe nuk bëri vlerësim tjetër për këtë pikë.

Shpend Ahmeti, Kryetar, shprehu habi me këtë veprim për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, neni 8, paragrafi 2, çdo komision komunal i aksionarëve i përgjigjet Kuvendit komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Komisioni komunal i aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, të përcaktuar në nenin 6.2 të këtij ligji, prandaj konsideroj se nuk ka pasur nevojë që të thirret kjo mbledhje, sepse këto janë të përcaktuara me ligj.

Për këtë temë diskutuan edhe Shefki Gashi, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Agim Gashi, Muhamet Selmani, Merita Surkishi dhe Shemsi Veseli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Duke pasur për bazë diskutimet, kryesuesi kërkoi që të merret ky

Konkluzion:

Kërkohet nga komisionet komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, që Kuvendit të Komunës së Prishtinës t'i paraqesin raporte me shkrim për çdo veprim të tyre të

marrë, në afat prej 7 ditësh nga dita e sotme. Raportet e kërkuara dorëzohen në sekretarinë e Kuvendit.

Njëherësh kërkoi që këtij konkluzioni t'i shtohet edhe një pikë tjetër:

“Tu sugjerohet komisioneve komunale të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, që të pezullojnë marrjen e çfarëdo veprimeve deri në një vendim të afërt të Komunës, d.m.th. një vendim, deri në vendimin e mbledhjes së ardhshme.

Kryesuesi konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 26 anëtarë, dhe e hodhi në votim pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se me njëzetegjashtë (26) vota për, u miratua Vendimi që komisionet komunale të aksionarëve t'i paraqesin raportet me shkrim mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe t'u sugjerohet këtyre komisioneve që të pezullojnë çdo ndërmarrje të çfarëdo veprimi të tyre deri në një vendim tjetër të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja mbaroi në orën 11:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.